VENDIM
Nr. 459, datë 30.7.2021

PËR PËRCAKTIMIN E RAJONEVE TË ZHVILLIMIT DHE KUFIJVE TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 102/2020, "Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin", me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rajoneve të zhvillimit dhe kufijve të tyre, si më poshtë vijon:

a) Rajoni i zhvillimit 1, i cili përfshin territoret që shtrihen në njësitë e vetëqeverisjes vendore:

i. të nivelit të parë: Shkodër, Malësi e Madhe, Fushë-Arrëz, Pukë, Vau i Dejës, Kukës, Has, Tropojë, Lezhë, Mirditë, Kurbin;

ii. të nivelit të dytë: Shkodër, Lezhë, Kukës;

sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Rajoni i zhvillimit 2, i cili përfshin territoret që shtrihen në njësitë e vetëqeverisjes vendore:

i. të nivelit të parë: Tiranë, Kamzë, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë, Durrës, Krujë, Shijak, Dibër, Mat, Klos, Bulqizë;

ii. të nivelit të dytë: Tiranë, Durrës, Dibër;

sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

c) Rajoni i zhvillimit 3, i cili përfshin territoret që shtrihen në njësitë e vetëqeverisjes vendore:

i. të nivelit të parë: Elbasan, Librazhd, Përrenjas, Gramsh, Cërrik, Peqin, Belsh, Korçë, Pogradec, Pustec, Maliq, Devoll, Kolonjë, Berat, Dimal, Kuçovë, Poliçan, Skrapar;

ii. të nivelit të dytë: Elbasan, Korçë, Berat;

sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

ç) Rajoni i zhvillimit 4, i cili përfshin territoret që shtrihen në njësitë e vetëqeverisjes vendore:

i. të nivelit të parë: Fier, Divjakë, Lushnjë, Roskovec, Patos, Mallakastër, Vlorë, Selenicë, Himarë, Delvinë, Sarandë, Finiq, Konispol, Gjirokastër, Memaliaj, Tepelenë, Përmet, Këlcyrë, Libohovë, Dropull;

ii. të nivelit të dytë: Vlorë, Fier, Gjirokastër;

sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Fondi Shqiptar i Zhvillimit, ministritë e linjës, njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe subjektet e tjera përgjegjëse në zhvillimin rajonal, të përcaktuara në nenin 7, të ligjit nr. 102/2020, "Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin", për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Aneks 1 : Harta e rajoneve të zhvillimit